



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.197/2 prot.

Datë 26.01.2024

V E N D I M
Nr. 92/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.22/2024, datë 09.01.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-79814-09-13-2023 me objekt “Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve spitalore”, me fond limit 14,706,700.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.10.2023, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK me NIPT L61814009B dhe adresë : Pasuria nr.1070, Zona Kadastrale 3965, Metalurgji, Bradashesh, Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Fier me adresë: Lagja “1 Maj” Rruga “Invalidet e Luftes”, Fier

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 09.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.22/2024, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-79814-09-13-2023 me objekt “Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve spitalore”, me fond limit 14,706,700.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.10.2023, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK, duke e kualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.216 prot., datë 18.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2596/18 prot., datë 23.01.2024, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 22/2024 datë 09.01.2024 duke i bashkëngjitur shkresës edhe Vendmimin nr. 164 prot., datë 15.01.2024 të titullarit të autoritetit kontraktor për zbatimin e vendimit të KPP nr. 22/2024.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.216 prot., datë 18.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2596/18 prot., datë 23.01.2024, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 22/2024 datë 09.01.2024 duke i bashkëngjitur shkresës edhe Vendmimin nr. 164 prot., datë 15.01.2024 të titullarit të autoritetit kontraktor për zbatimin e vendimit të KPP nr. 22/2024.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka kualifikuar operatorin ekonomik “Eco Riciklim” SHPK në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.22/2024 datë 09.01.2024.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr.22/2024 datë 09.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-79814-09-13-2023 me objekt “Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve spitalore”, me fond limit 14,706,700.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.10.2023, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejohet autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-79814-09-13-2023 me objekt “Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve spitalore”, me fond limit 14,706,700.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.10.2023, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

